



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV-13-1970

28 dhjetor 2021

Ankuesi

N Sh Skënderaj.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 28 dhjetor 2021, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN052-0942, i datës 30 gusht 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 02 tetor 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN052-0942, të datës 30 gusht 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara, në shumë të pa caktuar, nga NSH “Feronikeli” (në likuidim). Ankuesi pohoi se vendimi i kundërshtuar është i padrejtë sepse është marr në bazë të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me arsyetimin sipas agjencisë se elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitali apo pronësisë, kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore. Po ashtu ankuesi pohoi se nuk mendon se kërkesa e tij është jashtë afatit dhe nuk mendon që paraqet pengesë për një vendim të tillë në favor të tij, ku dihet se në çfarë vuajtjesh para lufte dhe gjatë luftës janë ballafaquar. Me tej ankuesi pohoi se duhet të kenë kompensim të pagave

për djersën e derdhur. Ankuesi propozoi që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe ti njihet e drejta ne kompensimin e pagave te mbetura.

Me 15 janar 2014, gjykata lëshoi urdhër me të cilin kërkoi nga ankuesi që të dorëzojë autorizimin për përfaqësuesin ligjor, përkthimin e ankesës ne gjuhën angleze, dorëzimin e vendimit kundër të cilit është ushtruar ankesa dhe dëshmi, prova shtese nëse ka për të mbështetur pretendimet e tij te parashtruara në ankesë. Urdhri është pranuar nga ankuesi, por nuk u përgjigj në të njëjtin.

Me 04 tetor 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesë, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura pohoi se e mbështet ne tërësi vendimin e AL mbi bazën e arsytimit te kërkesës siç parashihet me Shtojcën e Ligjit Nr. 04/L-034 të nenit 36.2.1 kur kërkesat apo pretendimet janë te pasafatshme sipas kufizimeve kohore te aplikueshme. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit edhe e parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punën së Bashkuar. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL

Me 06 tetor 2018, mbrojtja e të paditurës i është dorëzuar ankuesit, i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë kryesore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKM-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH “Feronikeli” kishte hyr në proces të likuidimit nga data 4 korrik 2006. AKM kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH “Feronikeli” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 26 shtator 2006. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor “Koha Ditore” me 26 korrik 2006 dhe në web sajtin e AKM-së.

Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën e tij Autoritetit të Likuidimit ia kishte parashtruar me datë 17 korrik 2007.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij te Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKM-ja. Ankuesi në ankesë nuk ka sjell asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit.

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 26 shtator 2006, e deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij me 17 korrik 2007 në Autoritetin e Likuidimit, kanë kaluar më shumë se nëntë muaj. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (C-IV-13-0003, C-IV-13-0652, C-IV-13-1754, C-IV-13-2063 dhe AC-I-14-0090) për refuzimin e ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditore janë parashtruar jashtë afatit për paraqitjen e tyre në AL.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit nuk është e caktuar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar